



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1065/12 prot

Datë 19.06.2024

V E N D I M
Nr. 708/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 19.06.2024 me

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Trimed” SHPK, në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr.REF-97233-03-04-2024 me objekt “Loti 1 – Blerje materiale mjekimi per nevoja spitalore”, me fond limit 6 533 020 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 26.03.2024, nga autoriteti kontraktor, Spitali “Ihsan Cabej” Lushnje.

Autoriteti Kontraktor: Spitali “Ihsan Cabej” Lushnje, me adresë: Lagjja “Xhevedet Nepravishta, Lushnje.

Ankimues: BOE “Biometric Albania” SHPK & “Montal” SHPK, përkatësisht me NUIS J61827062E, J62009007F, me adresë: Bulevardi Zhan D'ark, Pallati 53, Ap 6b, Tiranë.

Subjekte të Interesuara: Operatori ekonomik “Trimed” SHPK, me NUIS K51612031J, me adresë: Tiranë Kashar, Autostrada "Tiranë

- Durrës", Km 10, Zonë Kadastrale 2105, Nr. Pasurie 95/11.

Baza Ligjore:

Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur,

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

- I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt - ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.
- I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.
- I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.
- I.4. Ankimesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

- II.1. Në datën 05.03.2024, është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-97233-03-04-2024, me objekt “Loti 1 – Blerje

materiale mjekimi per nevoja spitalore”, me fond limit 6 533 020 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 26.03.2024, nga autoriteti kontraktor, Spitali “Ihsan Cabej” Lushnje.

II.2. Në datën 13.04.2024, operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, janë njoftuar elektronikisht për vlerësimin e ofertave, si më poshtë vijon:

“Trimed” SHPK	5. 987.891 lekë, kualifikuar
“Biometric Albania” SHPK	6.368.970 lekë, kualifikuar

II.3. Në datën 25.04.2024, autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit të procedurës së mësipërme të prokurimit në SPE.

II.4. Në datën 02.05.2024, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 1065/2024 protokollit dhe me numër ankimi elektronik A/2024/4040 e BOE “Biometric Albania” SHPK & “Montal” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr.REF-97233-03-04-2024 me objekt “*Loti 1 – Blerje materiale mjekimi per nevoja spitalore*”, me fond limit 6 533 020 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 26.03.2024, nga autoriteti kontraktor, Spitali “Ihsan Cabej” Lushnje.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës së sipërcituar, u konstatua, se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Trimed” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Konkretisht pretendohet si vijon:

“Pika e pare:

Ne daten 26.03.2024, prane AK Drejtoria e Spitalit “Ihsan Cabej” Lushnje, eshte paraqitur perfaqesuesi i BOE Biometric Albania & MONTAL sh.p.k., i cili ka dorezuar mostrat e materialeve te kerkuara sipas kerkeses se DST te cilesuar meposhte:

2.KRITERET E VECANTA TE KUALIFIKIMIT

2.3.9 Kerkohen te paraqiten mostra per te gjithë artikujt e ofruar. Dorezimi i Kampioneve/ mostrave te behet prane Spitalit “Ihsan Cabej” Lushnje, te mbyllura me ngjitese ne zarf/a ose kuti jo transparente te vulosur/a, mbi te cilin/at te shenohet: “Mos e hapni me perjashtim te rasteve kur eshte i pranishem Komisioni i vleresimit te Ofertave te kesaj procedure prokurimi dhe jo para dates 21.03.2024 ora 10:00

- Se bashku me mostrat ofertuesi duhet te jape edhe nje shkrese te vulosur dhe firmosur ku te listohen mostrat qe ndodhen ne zarf/kuti.

- Ne paketimin e cdo mostre duhet te evidentohet qarte origjina e mallit e cila duhet te perputhet me origjinen e deklaruar nga ofertuesi ne formularin e ofertes.

Data e zhvillimit te tenderit eshte shtyre nepermjet nje shtojce me ndryshime e cila ka percaktuar daten e re te zhvillimit te tenderit ne date 26.03.2024 pa ndryshime orari. Ne date 26.03.2024, ora 10.00, pervec perfaqesuesit te BOE Biometric Albania dhe MONTAL sh.p.k., nuk ka qene

asnje operator tjetër ekonomik i pranishëm në dorezimin e mostrave të kerkuara në piken 2.3.9 të DST të specifikuar më sipër.

Duke konstatuar në mënyrë surprize në sistemin elektronik të prokurimit pjesëmarrjen dhe kualifikimin e një operatori tjetër ekonomik (Trimed shpk), në datën 16.04.2024, në si Bashkim i Operatoreve Biometric Albania dhe Montal sh.p.k., bazuar në Ligjin Nr. 162/2020 datë 23.12.2020 për Prokurimin Publik, Neni 81, "E drejta për informim", i jemi drejtuar me një Kërkese për Informacion, AK Drejtoria e Spitalit "Ihsan Cabej" Lushnjë duke evidentuar mbi të gjitha faktin që asnjë operator tjetër nuk ka dorëzuar mostrat fizike brenda orarit të percaktuar në DST dhe duke kërkuar të paraqitet proces verbal i dorëzimit të mostrave të OE TRIMED shpk së bashku me dokumentacion shtesë. (bashkelidhur kopje e kesaj shkrese, protokolluar pranë AK Nr. 522 Prot. Datë 16.04.2024) Në vijim të kërkesës mesipërme, në datë 23.04.2024, jemi pajisur nga AK Drejtoria e Spitalit "Ihsan Cabej" Lushnjë me shkresën Kthim Pergjigje Nr. 522/1 Prot. Datë 19.04.2024 ku na është venë në dispozicion vetëm kopja e proces verbalit të dorëzimit të mostrave të Operatorit Ekonomik TRIMED shpk.

Në këtë proces verbal (shtojcë bashkëngjitur), me Nr. 415 Prot., datë 26.03.2024, konfirmohet fakti që mostrat fizike janë dorëzuar pranë Autoritetit Kontraktor në orën 10:30 në vend të orës 10.00 të percaktuar qartë në DST dhe në sistemin e prokurimit elektronik. Ky dokument është nënshkruar nga anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave dhe nga përfaqësuesi i Operatorit Ekonomik TRIMED shpk. Sa mesipër, në kuadër të Ligjit të Prokurimit Publik dhe Neneve përkatëse të listuara mëposhtë është e qartë që ofertat e Operatoreve Ekonomike pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi nuk janë trajtuar në mënyrë të barabartë. [...]

Konkretisht, oferta e OE TRIMED shpk nuk duhej të ishte marrë në konsideratë për vlerësim për sa kohë është verifikuar mosplotësimi i një kushti thelbësor skualifikimi të percaktuar në DST, që është dorëzimi i mostrave sipas KRITEREVE TË VECANTA TË KUALIFIKIMIT, Pika 2.3.9. Vlerësimi i ofertës së TRIMED shpk si oferte e vlefshme është diskriminues ndaj BOE Biometric Albania & MONTAL sh.p.k. Dhe në shkëlqje me nenet e listuar mesipër për sa kohë që rezultoni e qartë që TRIMED shpk nuk ka respektuar piken 2.3.9 të percaktuar në DST. Dëshmise së përfaqësuesit të BOE Biometric Albania dhe MONTAL sh.p.k. Që në orarin zyrtar të dorëzimit të mostrave (ora 10.00) nuk ka pasur operatore të tjere ekonomike pjesëmarrës, i shtohet KONFIRMIMI i orarit 10.30 të dorëzimit të mostrave nga TRIMED shpk të dokumentuar në proces verbal.

Sa mesipër, kërkojmë që oferta e Operatorit Ekonomik TRIMED shpk të skualifikohet duke qenë se nuk ka përmbushur kërkesën e pikës 2.3.9 të percaktuar në DST.

Pika e dytë:

Në shkresën drejtuar AK Drejtoria e Spitalit "Ihsan Cabej" Lushnjë protokolluar pranë AK Nr. 522 Prot. Datë 16.04.2024, përveç procesverbalit të dorëzimit dhe administrimit të mostrave të OE Trimed shpk, në si BOE Biometric Albania dhe MONTAL sh.p.k. i kemi kërkuar këtë Autoriteti Kontraktor të na vendose në dispozicion edhe dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kataloget teknike për të gjithë artikujt e ofruar (sipas kriterit 2.3.8 të DST).
- Listen e cmimeve të artikujve, në të cilën është vetedëklaruar origjina e mallit dhe kompania/te prodhuese (sipas kriterit 2.3.2 të DST).

Kjo per te verifikuar perputhshmerine e kompanive te deklaruar me prodhuesit perkates te pasqyruar ne katalogun teknik te artikujve objekt prokurimi.

Kerkesa jone perligjet dhe bazohet ne Ligjin Nr. 162/2020 date 23.12.2020 per Prokurimin Publik, Neni 81, "e drejta per informim", [...], sikurse dhe ne Dokumentet Standarde te Tenderit, Shtojca 4 ku citohet se: Nuk konsiderohet se perben sekret tregtar informacioni qe duhet te behet publik sipas ligjit, qe ka te beje me nje shkelje te ligjit ose qe duhet te publikohet ne baze te praktikave te mira tregtare dhe parimeve te etikes tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund te klasifikoje si konfidencial: cmimin e ofertes, listen e cmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e perzgjedhjes se ofertes, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publike dhe informacione te tjera qe duhet te behen publike ose qe nuk jane konfidenciale ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.

Ne shkresen Kthim Pergjigje Nr. 522/1 Prot. Date 19.04.2024 nga Drejtoria e "Ihsan Cabej" Lushnje, ky autoritet nuk na ka vendosur ne dispozicion dokumentacionin e mesiperm, ne kundershkrim te plote me Ligjin Nr. 162/2020 date 23.12.2020 per Prokurimin Publik, Neni 81 si dhe Dokumentat Standard te Tenderit, Shtojca 4. Ne i jemi drejtuar perseri AK me ane te postes elektronike (e-mail bashkelidhur date 25.04.2024) duke i kerkuar te respektoje DST dhe Ligjin Nr. 162/2020 date 23.12.2020 per Prokurimin Publik dhe te na vendose ne dispozicion dokumentacionin e munguar. Ne lidhje me kete kerkesa nuk kemi marre asnje pergjigje nga AK Te ndodhur para nje situate te tille, ku Autoriteti Kontraktor nuk respekton Ligjet dhe Rregullat e Prokurimit Publik si dhe DST, i drejtohem Komisionit te Prokurimit Publik si organi me i larte administrativ dhe vendimmarres qe me forcen qe i jep Ligji t'i kerkoje Autoritetit Kontraktor te na vendose ne dispozicion dokumentacionin e mesiperm. Duke qene se barra e proves bie mbi ne si BOE ankimues, ne kete menyre ne po kerkojme ne perputhje te plote me Ligjet dhe Rregullat ne fuqi te Prokurimit Publik, te sigurojme faktet dhe provat konkrete qe produktet e ofruara nga OE Trimed shpk ne kete procedure prokurimi nuk jane ne perputhje me specifikimet teknike te kerkuara, si dhe qe dokumentacioni i paraqitur (si autorizime dhe certifikata prodhuesish) eshte jashte kriterëve te percaktuar ne DST.

Qe nje oferte te konsiderohet e rregullt dhe sipas kerkesave ne DST, nevojitet qe te gjithë elementet e mesiperm te jene korrekte dhe ne perputhshmeri me njeri tjetrin, cka do te thote qe:

- 1. Kompanite prodhuese dhe origjina mbi paketimin e cdo mostre (te cilat duhet te evidentohen qarte) duhet te jene te njejta me origjinen dhe prodhuesit e deklaruar ne formularin e ofertes.*
- 2. Te verifikohet qe nga Prodhuesi i evidentuar mbi paketimin e mostres dhe ne formularin e ofertes, eshte marre Autorizim i rregullt drejtuar kompanise Trimed shpk per shitjen e produkteve objekt prokurimi ne territorin e Shqiperise.*
- 3. Prodhuesit perkates te evidentuar ne katalogun e paraqitur te jene te njejte me ata te paraqitur ne oferte, dokumentacion dhe paketimin e mostrave.*
- 4. Kodet e produkteve mbi paketimin e mostrave duhet te jene ne perputhje me kodet e paraqitura ne kataloget perkates si dhe ne Certifikatat CE te konformitetit (sipas kategorizimit perkates).*
- 5. Specifikimet e markuara ne katalog te jene ne perputhje te plote me specifikimet teknike te artikujve te kerkuar ne DST.*

6. Produktet e ofertuara duhet te jene te pasqyruara me emertimet perkatese ne Certifikatat CE dhe Deklaratat e Konformitetit sipas prodhuesve te deklaruar ne oferte.

7. Certifikatat CE te jene te rregullta sipas Direktivave perkatese dhe te vlefshme ne daten e hapjes se tenderit, ose ne rast se kane kaluar daten e skadences te jene te shoqeruara me Dokument Konfirmimi nga Organi Certifikues per zgjatje te vlefshmerise sipas Rregullores (EU) 2023/607 te Keshillit European.

Per te gjitha pikat e mesiperme, bazuar ne pervojat tona te meparshme, ne si BOE ngrejme dyshimet tona te arsyeshme qe ato nuk permbushen nga OE Trimed shpk, dyshime te cilat perforcohen me mungesen e transparences nga Autoriteti Kontraktor dhe faktin qe KVO ka pranuar dhe administruar mostrat e kesaj kompanie jashte orarit te zhvillimit se tenderit, ne kundersiztim me piken 2.3.9 te DST.

Per me teper, ne lidhje me produktet objekt prokurimi, te cilat jane Materiale Mjekesore te Pergjithshme (MMI), ne si bashkim operatoresh kemi marre pjese ne shume procedura realizuar nga te gjitha spitalet universitare dhe rajonale ne territorin e Shqiperise. Ne procedurat e meposhtme pjesemarrjes ka qene edhe operatori ekonomik Trimed shpk, i cili eshte skualifikuar per arsyet ne vijim:

1. Procedura e zhvilluar nga Drejtoria e Sherbimit Spitalor Kukes, date 26.02.2024 Operatori Trimed shpk eshte skualifikuar per mospermbushje te kriterëve ne DST, sic jane Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, dhe mosparaqitja e mostrave per artikujt e kerkuar. (Publikuar ne Buletinin Nr. 15 te dates 18 Mars 2024).

2. Procedura e zhvilluar nga Drejtoria e Sherbimit Spitalor Sarande, date 01.03.2024 Operatori Trimed shpk eshte skualifikuar per mospermbushje te kriterëve ne DST.

3. Procedura e zhvilluar nga Spitali Universitar i Traumes, date 04.03.2024 Operatori Trimed shpk eshte skualifikuar per mospermbushje te kriterëve ne DST.

4. Procedura e zhvilluar nga Spitali Rajonal Shkoder, date 20.03.2024 Operatori Trimed shpk eshte skualifikuar per mospermbushje te kriterëve ne DST.

5. Procedura e zhvilluar nga Drejtoria e sherbimit Spitalor Pogradec, date 02.04.2024 Operatori Trimed shpk eshte skualifikuar per mospermbushje te kriterëve ne DST.

Ju veme ne dukje se ne te gjitha keto procedura, artikujt objekt prokurimi jane te njejte, me ndryshime te vogla sipas nevojave te autoriteteve kontraktore perkatese. Fakti qe operatori Trimed shpk eshte skualifikuar ne keto procedura te njepasnjeshme duke mos plotesuar kriteret qe ne si BOE kemi paraqitur ne ankesen tone, konfirmon dhe perforcon dyshimet tona te arsyeshme qe ky operator nuk ka ofruar produkte mjekesore sipas te gjitha standardeve, kriterëve dhe specifikimeve teknike te percaktuara ne DST-te respektive. Duke qene se behet fjale per produkte identike te prokuruar ne autoritetet kontraktore te siperpermendura, mungesa e dokumentacionit apo mosperpuethshmeria e mostrave te paraqitura nga OE Trimed shpk ne keto procedura (e cila ka qene edhe arsyeja e skualifikimit te ketij OE), eshte nje indicie konkrete dhe prove e forte mbi bazen e te cilave duhet te shqyrtohen pretendimet tona.

Per sa me siper, KVO ka vepruar me njeanshmeri dhe vleresim te padrejte ne kete procedure prokurimi, ne kundersiztim me Nenin 2 te Ligjit Nr. 162/2020 date 23.12.2020 per Prokurimin Publik [...].

Si perfundim, kerkojme nga KSHA dhe me tej KPP, qe ne zbatim te Ligjit Nr. 162/2020 date 23.12.2020 per Prokurimin Publik, Vendimit Nr. 285, date 19.5.2021 per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik te behet verifikimi i detajuar i mostrave te paraqitura nga Trimed shpk, nese ato jane ne perputhje me dokumentacionin e permendur ne argumentimin me lart, verifikimi i specifikimeve teknike te markuara ne katalog me ato te kerkuara ne DST, si dhe verifikimi i dokumentave te faktit, ligjore dhe teknike te paraqitur nga OE Trimed shpk ne kete procedure prokurimi. Kerkojme skualifikimin e ofertes te OE Trimed shpk duke e cilesuar ate si jo te rregullt dhe ne kundershtrim me kriteret e percaktuara ne DST, Ligjin Nr. 162/2020 date 23.12.2020 per Prokurimin Publik, Vendimin Nr. 285, date 19.5.2021 per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik.”

II.5. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. Prot., 1065/2, datë 03.05.2024, me kriteret që BOE “Biometric Albania” SHPK & “Montal” SHPK pretendon, se nuk përmbushen nga shoqëria Trimed” SHPK.

II.6. Në datën 07.05.2024, në Komisionin e Prokurimit Publik është protokolluar me nr. 1065/3, shkresa e autoritetit kontraktor me nr. 632/1 prot., datë 03.05.2024, me objekt: “Njoftim lidhur me ankesën nr. A/2024/4040”, drejtuar Komisionit të Prokurimit Publik, për dijeni subjektit ankimues. Sipas kësaj shkrese rezulton, se autoriteti kontraktor e ka refuzuar ankesën e bahkimit të operatorëve ekonomikë “Biometric Albania” SHPK & “Montal” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit, me argumentin, se është paraqitur jashtë afateve ligjore.

II.7. Në datën 08.05.2024 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik, me nr. 1065/4 prot., “Formulari i paraqitjes së argumenteve”, nga operatori ekonomik i interesuar “Trimed” SHPK, në përputhje me nenin 113, ligji Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

II.8. Nëpërmjet shkresës nr. 1065/5 prot., datë 15.05.2024, me objekt: “Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacioni KPP-së lidhur me ankesën e BOE “Biometric Albania” SHPK & “Montal” SHPK”, Komisioni i Prokurimit Publik i kërkoi autoritetit kontraktor të sjellë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e kësaj shkrese, informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesës së ankimuesit, shoqëruar me mostrat e paraqitura nga shoqëria “Trimed” SHPK, si dhe procesverbali i KVO-së lidhur me marrjen në dorëzim të mostrave të dorëzuara nga ky i fundit në procedurën e mësipërme të prokurimit, sipas Udhëzimit nr.3, datë 12.04.2022 të Agjencisë së Prokurimit Publik, “Mbi procesin e administrimit të mostrave të paraqitura nga operatorët ekonomikë”.

II.9. Në datën 20.05.2024, është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 1065/6 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr. 727/1 prot., datë 17.05.2024, me objekt: “Dërgim informacioni”. Me anë të kësaj shkrese, autoriteti kontraktor informon se:

“[...] Në orën 10.00 janë paraqitur OE si më poshtë:

BOE “Biometric Albania” SHPK & “Montal” SHPK

OE “Trimed” SHPK

[...]

të cilëve në rendin rendor të mësipërm u janë marrë mostrat për të cilat është mbajtur procesverbali përkatës dhe po ua dërgojmë bashkëngjitur [...].”

Bashkëngjitur shkresës, procesverbalet e punës së KVO-së për marrjen në dorëzim të mostrave.

II.10. Nëpërmjet shkresës nr. 1065/8 prot., datë 27.05.2024, me objekt: “Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacioni KPP-së lidhur me ankesën e BOE “Biometric Albania” SHPK & “Montal” SHPK”, Komisioni i Prokurimit Publik i kërkoi autoritetit kontraktor si vijon:

“[...] Me shkresën me nr. 1065/5 prot., datë 15.05.2024, Komisioni i Prokurimit Publik i kërkoi autoritetit kontraktor informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesës së ankimesit, shoqëruar me mostrat e paraqitura nga shoqëria “Trimed” SHPK si dhe procesverbali i KVO-së lidhur me marrjen në dorëzim të mostrave të dorëzuara nga ky i fundit në procedurën e mësipërme të prokurimit, sipas Udhëzimit nr.3, datë 12.04.2022 të Agjencisë së Prokurimit Publik “Mbi procesin e administrimit të mostrave të paraqitura nga operatorët ekonomikë”.

Në datën 20.05.2024, është protokolluar në KPP me nr. 1065 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr. 727/1 prot., datë 17.05.2024, me objekt: “Dërgim informacioni”, bashkëngjitur dokumentacioni përkatës, por mungojnë mostrat e paraqitura nga shoqëria “Trimed” SHPK.

Për sa më sipër, me qëllim vijimin e gjykimit të ankesës pranë KPP-së, në përputhje me nenin 114 të LPP-së, autoriteti kontraktor të dërgojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e kësaj shkrese, mostrat e paraqitura nga shoqëria “Trimed” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.”

II.11. Në datën 04.06.2024, është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 1065/9 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr. 846 prot., datë 03.05.2024, me objekt: “Kthim - përgjigje”, bashkëngjitur procesverbali nr. 821/2 prot., datë 31.05.2024 i KVO-së, për mostrat e paraqitura nga operatori ekonomik “Trimed” SHPK, për procedurën e prokurimit me objekt Loti MM 1 “Blerje materiale mjekimi të përgjithshme”, të renditura në një tabelë me emërtimet e artikujve, si dhe u dorëzuan në KPP mostrat e paraqitura në tender nga shoqëria “Trimed” SHPK.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit e dokumentacionit të paraqitur nga ana e autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e BOE “Biometric Albania” SHPK & “Montal” SHPK se: *“Ne daten 26.03.2024, prane AK Drejtoria e Spitalit “Ihsan Cabej” Lushnje, eshte paraqitur perfaqesuesi i BOE Biometric Albania & MONTAL sh.p.k., i cili ka dorezuar mostrat e materialeve te kerkuara sipas kerkeses se DST te cilesuar me poshte:*

2.KRITERET E VECANTA TE KUALIFIKIMIT

2.3.9 Kerkohen te paraqiten mostra per te gjithë artikujt e ofruar. Dorezimi i Kampioneve/ mostrave te behet prane Spitalit “Ihsan Cabej” Lushnje, te mbyllura me ngjitesë ne zarf/a ose kuti jo transparente te vulosur/a, mbi te cilin/at te shenohet: “Mos e hapni me perjashtim te rasteve kur eshte i pranishem Komisioni i vleresimit te Ofertave te kesaj procedure prokurimi dhe jo para dates 21.03.2024 ora 10:00

- Se bashku me mostrat, ofertuesi duhet te jape edhe nje shkrese te vulosur dhe firmosur ku te listohen mostrat qe ndodhen ne zarf/kuti.

- Ne paketimin e cdo mostre duhet te evidentohet qarte origjina e mallit e cila duhet te perputhet me origjinen e deklaruar nga ofertuesi ne formularin e ofertes.

Data e zhvillimit te tenderit eshte shtyre nepermjet nje shtojce me ndryshime e cila ka percaktuar daten e re te zhvillimit te tenderit ne date 26.03.2024 pa ndryshime orari. Ne daten 26.03.2024, ora 10.00, pervec perfaqesuesit te BOE Biometric Albania dhe MONTAL sh.p.k., nuk ka qene asnje operator tjetër ekonomik i pranishem ne dorezimin e mostrave te kerkuara ne piken 2.3.9 te DST te specifikuar me siper. Duke konstatuar ne menyre surprize ne sistemin elektronik te prokurimit pjesemarrjen dhe kualifikimin e nje operatori tjetër ekonomik (Trimed shpk), ne daten 16.04.2024, ne si Bashkim i Operatoreve Biometric Albania dhe Montal sh.p.k., bazuar ne Ligjin Nr. 162/2020 date 23.12.2020 per Prokurimin Publik, Neni 81, “E drejta per informim”, i jemi drejtuar me nje Kerkese per Informacion, AK Drejtoria e Spitalit “Ihsan Cabej” Lushnje duke evidentuar mbi te gjitha faktin qe asnje operator tjetër nuk ka dorezuar mostrat fizike brenda orarit te percaktuar ne DST dhe duke kerkuar te paraqitet proces verbali i dorezimit te mostrave te OE TRIMED shpk se bashku me dokumentacion shtese. (bashkelidhur kopje e kesaj shkrese, protokolluar prane AK Nr. 522 Prot. Date 16.04.2024). Ne vijim te kerkeses mesiperme, ne date 23.04.2024, jemi pajisur nga AK Drejtoria e Spitalit “Ihsan Cabej” Lushnje me shkresen Kthim Pergjigje Nr. 522/1 Prot. Date 19.04.2024 ku na eshte vene ne dispozicion vetem kopja e proces verbalit te dorezimit te mostrave te Operatorit Ekonomik TRIMED shpk. Ne kete procesverbal (shtojce bashkëngjitur), me Nr. 415 Prot., date 26.03.2024, konfirmohet fakti qe mostrat fizike jane dorezuar prane Autoritetit Kontraktor ne oren 10:30 ne vend te ores 10.00 te percaktuar

qarte ne DST dhe ne sistemin e prokurimit elektronik. Ky dokument eshte nenshkruar nga anetaret e komisionit te vleresimit te ofertave dhe nga perfaqesuesi i Operatorit Ekonomik TRIMED shpk. Sa me siper, ne kuader te Ligjit te Prokurimit Publik dhe Neneve perkatese te listuara me poshte, eshte e qarte qe ofertat e Operatoreve Ekonomike pjesemarres ne kete procedure prokurimi nuk jane trajtuar ne menyre te barabarte. [...] Konkretisht, oferta e OE TRIMED shpk nuk duhej te ishte marre ne konsiderate per vleresim per sa kohe eshte verifikuar mosplotesimi i nje kushti thelbesor skualifikimi te percaktuar ne DST, qe eshte dorezimi i mostrave sipas KRITEREVE TE VECANTA TE KUALIFIKIMIT, Pika 2.3.9. Vleresimi i ofertes se TRIMED shpk si oferte e vlefshme eshte diskriminues ndaj BOE Biometric Albania & MONTAL sh.p.k. Dhe ne shkelje me nenet e listuara me siper per sa kohe qe rezulton e qarte qe TRIMED shpk nuk ka respektuar piken 2.3.9 te percaktuar ne DST. Deshmise se perfaqesuesit te BOE Biometric Albania dhe MONTAL sh.p.k. qe ne orarin zyrtar te dorezimit te mostrave (ora 10.00) nuk ka pasur operatore te tjere ekonomike pjesemarres, i shtohet KONFIRMIMI i orarit 10.30 te dorezimit te mostrave nga TRIMED shpk te dokumentuar ne proces verbal. Sa mesiper, kerkojme qe oferta e Operatorit Ekonomik TRIMED shpk te skualifikohet duke qene se nuk ka permbushur kerkesen e pikes 2.3.9 te percaktuar ne DST”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 2.3.9 në dokumentet e tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

2.3.9 Kërkohen të paraqiten mostra për të gjithë artikujt e ofruar. Dorëzimi i Kampioneve/ mostrave të bëhet pranë Spitalit ”Ihsan Cabej” Lushnje, të mbyllura me ngjitëse në zarf/a ose kuti jotransparente të vulosur/a, mbi të cilin/at të shënohet: “Mos e hapni me përjashtim te rasteve kur është i pranishëm Komisioni i Vlerësimit te Ofertave të kësaj procedure prokurimi dhe jo para datës 26.03.2024 ora 10:00.

- Së bashku me mostrat ofertuesi duhet të japë edhe një shkresë të vulosur dhe firmosur ku të listohen mostrat që ndodhen në zarf/kuti.

- Në paketimin e çdo mostre duhet të evidentohet qartë origjina e mallit e cila duhet të përputhet me origjinën e deklaruar nga ofertuesi në formularin e ofertës.”

III.1.2. Nga ana e AK-së argumentohet si vijon: “[...] Në orën 10.00 janë paraqitur OE si më poshtë: BOE “Biometric Albania” SHPK & “Montal” SHPK; OE “Trimed” SHPK [...], të cilëve në rendin rendor të mësipërm u janë marrë mostrat për të cilat është mbajtur procesverbali përkatës dhe po ua dërgojmë bashkëngjitur [...]”. Bashkëngjitur procesverbalet e punës së KVO-së për marrjen në dorëzim të mostrave.”

III.1.3. Në nenin 77, pikën 5 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: “5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.

III.1.4. Në nenin 40, pika 6, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

- a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose*
- b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose*
- c) dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.”.*

III.1.5. Në Udhëzimin nr.3, datë 12.04.2022 të Agjencisë së Prokurimit Publik “Mbi procesin e administrimit të mostrave të paraqitura nga operatorët ekonomikë”, APP udhëzon si vijon:

1. Autoriteti//Enti kontraktor, mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë mostra të mallit, objekt prokurimi, kur gjykon se është e rëndësishme për vlerësimin e aspektit teknik të ofertës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë teknikisht vendosjen e kriterit për kualifikim për paraqitjen e mostrave, dhe ky argumentim duhet të pasqyrohet në procesverbalin e argumentimit të specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta të pranimit, i cili publikohet së bashku me dokumentet e tenderit në Sistemin e Prokurimit Publik (në vijim “SPE).

2. Paraqitja e mostrave i shërben autoritetit/entit kontraktor për të gjykuar më mirë mbi përmbushjen e specifikimeve të kërkuara për objektet që prokurohet, me qëllim që, cilësia e mallit të jetë në përputhje me kërkesat e përcaktuara prej tij.

3. Për të dokumentuar procesin e administrimit të mostrave, autoriteti/enti kontraktor duhet të mbajë procesverbale, me qëllim sigurimin e transparencës dhe integritetit të këtij procesi.

Në këtë kuptim, në rastin kur autoriteti/enti kontraktor vlerëson si të nevojshëm dorëzimin e mostrave, në datën dhe në orën e përcaktuar në dokumentat e tenderit për paraqitjen e tyre nga

ofertuesit, duhet të mbajë një procesverbal. Procesverbali duhet të dokumentojë procesin e paraqitjes së mostrave, si dhe duhet të pasqyrojë detaje që përshkruajnë mostrën/at e administruara.

Në këtë rast, mbajtja e procesverbaleve i shërben vetëm procesit të paraqitjes së mostrave deri në momentin e kthimit të tyre tek ofertuesit.

Procesverbali i mbajtur me ofertuesin/ofertuesit e pranishëm, i cili duhet të nënshkruhet nga të dyja palët (përfaqësuesi/it i autoritetit/entit kontraktor dhe i ofertuesit/ve), duhet t'i vihet në dispozicion ofertuesit/ve.

Në rast se, ndonjëra nga palët ka komente/pretendime, ato duhet të pasqyrohen në procesverbalin e mbajtur.

4. Mostrat e paraqitura nga ofertuesit duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor.

Mostrat e administruara do t'i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, 30 (tridhjetë) ditë pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që, kontrata në fjalë, të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor.

Në rastin kur, procedura e prokurimit anulohet, mostrat do t'i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit.

5. Në rastin kur, në një procedurë prokurimi, në të cilën është kërkuar paraqitja e mostrave, ka ankesa nga operatorët ekonomikë mbi dokumentet e tenderit dhe në përfundim të shqyrtimit të tyre, administrativisht është vendosur që të mos ketë modifikime në dokumentet e tenderit pra, autoriteti/enti kontraktor do të vijojë me hapjen e ofertave, atëherë ky i fundit do të nxjerrë procedurën e prokurimit nga procesi i pezullimit në SPE, si dhe do të vendosë datën e hapjes së ofertave, në mënyrë të tillë që, t'i japë mundësi operatorëve ekonomikë pjesëmarrës të dorëzojnë mostrat e kërkuara.

6. Në procedurat e prokurimit me vlerë të vogël, kur autoritetet/entet kontraktore kanë nevojë që të kërkojnë mostra për objektin që do të prokurojnë, duhet të kenë kujdes që mostra t'i kërkohe vetëm operatorët ekonomik të renditur në vend të parë, përpara se ai të shpallet fitues dhe kështu me rradhë ofertuesve të tjerë, duke patur në vëmendje parashikimet e pikës 17 të Udhëzimit të APP Nr. 5, datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”. [...].”

III.1.6. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj, autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit

dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit, është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 dhe 3 të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik” ka për detyrë d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dhe të garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

III.1.7. Nga shqyrtimi në tërësi i fakteve dhe rrethanave të çështjes objekt-shqyrtimi, KPP vëren se autoriteti kontraktor në kriterin e veçantë të kualifikimit, ka kërkuar nga ana e operatorëve ekonomikë të plotësojnë kushtin për të paraqitur *mostra për të gjithë artikujt e ofruar. Dorëzimi i Kampioneve/ mostrave të bëhet pranë Spitalit “Ihsan Cabej” Lushnje, të mbyllura me ngjitëse në zarf/a ose kuti jo transparente të vulosur/a, mbi të cilin/at të shënohet: “Mos e hapni me përjashtim të rasteve kur është i pranishëm Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të kësaj procedure prokurimi dhe jo para datës 26.03.2024 ora 10:00. Së bashku me mostrat ofertuesi duhet të japë edhe një shkresë të vulosur dhe firmosur ku të listohen mostrat që ndodhen në zarf/kuti. Në paketimin e çdo mostre duhet të evidentohet qartë origjina e mallit e cila duhet të përputhet me origjinën e deklaruar nga ofertuesi në formularin e ofertës”.*

Në datën 20.05.2024, është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 1065/6 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr. 727/1 prot., datë 17.05.2024, me objekt: “Dërgim-informacioni”. Me anë të kësaj shkrese, autoriteti kontraktor informon, se: “[...] Në orën 10.00 janë paraqitur OE si më poshtë: BOE “Biometric Albania” SHPK & “Montal” SHPK; OE “Trimed” SHPK [...], të cilëve në rendin rendor të mësipërm u janë marrë mostrat për të cilat është mbajtur procesverbali përkatës dhe po ua dërgojmë bashkëngjitur [...]”. Bashkëngjitur shkresës procesverbalet e punës së KVO-së për marrjen në dorëzim të mostrave. Nga shqyrtimi i dokumentacionit bashkëngjitur kësaj shkrese rezulton, se nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave është mbajtur procesverbal me datë 26.03.2024, ora 10, për mostrat e sjella nga BOE “Montal” SHPK & “Biometric” SHPK për lotin MM1, bashkëngjitur lista e mostrave të 44 artikujve, të nënshkuara nga nga përfaqësuesi i BOE, si dhe është mbajtur procesverbal me datë 26.03.2024, ora 10:30, për mostrat e sjella nga operatori ekonomik “Trimed” SHPK për lotin MM1, bashkëngjitur lista e mostrave të 44 artikujve, të nënshkuara nga ky i fundit. Gjithashtu konstatohet, se bashkëngjitur shkresës në fjalë, nga ana e autoritetit kontraktor janë paraqitur edhe dy procesverbale të mbajtura me dy shoqëri të tjera pjesëmarrëse në lotin 2 të procedurës së prokurimit, me datë 26.03.2024, Ora 10.00.

Nga shqyrtimi i procesverbaleve të KVO-së për lotin 1 objekt - shqyrtimi, si më sipër cituar, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se procesverbali i marrjes në dorëzim të mostrave të dy shoqërive pjesëmarrëse në procedurën e mësipërme të prokurimit, është bërë në orare të ndryshme, duke vënë në dyshim kohën e paraqitjes së subjektit “Trimed” SHPK për dorëzimin e mostrave në autoritetin kontraktor. Në udhëzimin nr.3 të APP-ë thuhet, se: “Për të dokumentuar procesin e administrimit të mostrave, autoriteti/enti kontraktor duhet të mbajë procesverbale, me qëllim sigurimin e transparencës dhe integritetit të këtij procesi.”

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se me dokumentacionin e dorëzuar, autoriteti kontraktor nuk arrin të provojë se përfaqësues të operatorit ekonomik “Trimed” SHPK kanë qenë prezent në orarin e caktuar në dokumentet e tenderit (10:00) për dorëzimin e mostrave, duke e kthyer këtë procedurë në të njëanshme.

III.1.8. Bazuar në nenin 118, pika 2, gërma “b” të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, sipas të cilit: *“Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin; nenit 98, pika 1, gërma “d” të këtij ligji ku thuhet shprehimisht: “Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin sipas parashikimeve në këtë ligj”, si dhe në nenin 45, pika 1 gërma “b” të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, ku parashikohet se: “[...]Komisioni i Prokurimit Publik në kuadër të veprimtarisë së shqyrtimit të ankesave para lidhjes së kontratës procedon me: b) Vendim për pranimin e ankesës dhe urdhërimin e autoritetit/entit kontraktor, që të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se parregullsitë e konstatuara në procedurën e ndjekur nga KVO-ja për marrjen në dorëzim të mostrave të paraqitura, është haptazi jo në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik, ndaj, përbën shkak për anulimin e procedurës së prokurimit, me qëllim trajtimin e barabartë, transparent dhe jodiskriminues të operatorëve ekonomikë.*

Në këto kushte, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të anulojë procedurën e prokurimit dhe në rishpalljen e saj të mbajë në konsideratë konstatimet e këtij vendimi.

Pretendimet e ankimuesit qendrojnë pjesërisht.

III.2. Lidhur me pretendimet e ankimuesit të parashtuara në pikën 2 të ankesës si më sipër cituar, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se operatori ekonomik ankimues nuk parashtron fakte apo dyshime të bazuara, por ngre pretendime *a-priori*, duke ngritur dyshime e hamendësime, lidhur me plotësimin e kriterëve nga opeatori ekonomik “Trimed” SHPK në procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

Referuar Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton paraprakisht ankesën nga ana formale duke verifikuar (krahas juridiksionit administrativ dhe kompetencës lëndore, legjitimitetit të ankimuesit dhe respektimit afateve), edhe “elementet e domosdoshme të ankesës”, sipas përcaktimeve të nenit 48, “Kushtet formale të ankesës”, pika 3:

Ankesa, sipas rastit, mund të shoqërohet edhe me: a) provat dokumentare, të cilat ankimuesi kërkon të shqyrtohen nga Komisioni”.

Bazuar në sa më sipër, KPP gjykon, se ankimuesi duhej të kishte shoqëruar pretendimet e tij me prova, indicie dhe argumente, në bazë të të cilave do të shqyrtohen këto pretendime. Vlen të ritheksojmë, se Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ, i cili në kuptim të nenit 90 të LPP dhe nenit 80 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, shqyrton ankesat mbi vendimet e marra nga KVO e autoritetit kontraktor, por ligjvënësi qartazi i ka ndarë detyrat dhe kompetencat e këtyre dy organeve. Operatori ekonomik ka detyrimin që ta bëjë të identifikueshëm pretendimin e tij mbi shkeljen e pretenduar, pra të evidentojë qartë dhe saktë se ku e bazon pretendimin e tij. Është barrë e operatorit ekonomik që të përcaktojë, se në cilin fakt apo rrethanë e mbështet pretendimin e tij për kualifikimin e padrejtë të shoqërisë “Trimed” SHPK. Një ankim në total, pa argumente të arsyeshme apo indicie të qarta, mbi të gjitha apo shumicën e elementeve përbërëse të dokumenteve të tenderit, do të konsiderohet abuziv, në kundërshtim me qëllimin e veprimtarisë së Komisionit, pasi cenon efikasitetin dhe shpejtësinë e procedurës së prokurimit publik dhe nuk do të merret në shqyrtim nga KPP.

KPP është paraparë nga ligji si një *quasi* gjykatë. Si i tillë në vendimmarrjen e tij, Komisioni i Prokurimit Publik zbaton parimet kryesore të së drejtës. Një prej tyre është edhe parimi juridik i cili thekson faktin, se gjykata vendos në bazë të akuzave (pretendimeve) dhe provave. Komisioni i Prokurimit Publik, refuzon të vendoset në pozitën e avokatit të ankimuesit e të investohet mbi një ankim i cili nuk mbështetet në asnjë argument.

Rrjedhimisht pretendimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimues, nuk merren në shqyrtim.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “*Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik*”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e*

Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e BOE “Biometric Albania” SHPK & “Montal” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr.REF-97233-03-04-2024 me objekt “*Loti 1 – Blerje materiale mjekimi per nevoja spitalore*”, me fond limit 6 533 020 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 26.03.2024, nga autoriteti kontraktor, Spitali “Ihsan Cabej” Lushnje.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë procedurën e mësipërme të prokurimit dhe me rihapjen e procedurës, të ketë parasysht konstatimet e bëra nga Komisioni i Prokurimit Publik në këtë vendim.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga BOE “Biometric Albania” SHPK & “Montal” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaïd Myzyri

